14. Deklasifikimin e plotë të dosjes personale dhe të punës nr. 332, në ngarkim të F.D, me pseudonimin "Joviku", me 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) fletë. Dosja i përket Fondit të Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.
15. Deklasifikimin e plotë të, fotokopje e vendimit mbi veçimin për asgjesim në ngarkim të pseudonimit "ylli" me 1(një) fletë. Vendimi i përket Fondit të Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.
16. Deklasifikimin e plotë të, fotokopje e vendimit mbi veçimin për asgjesim në ngarkim të pseudonimit "ylli" me 1(një) fletë. Vendimi i përket Fondit të Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.
17. Deklasifikimin e plotë të, fotokopje e vendimit mbi veçimin për asgjesim në ngarkim të pseudonimit "aviatori" me 2(dy) fletë. Vendimi i përket Fondit të Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.
18. Deklasifikimin e plotë të dosjes së punës nr. 1402, në ngarkim të H.P, pseudonimi "pashtriku" me 187 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
19. Deklasifikimin e plotë të dosjes personale dhe të punës nr. 17, në ngarkim të Gj. A, pseudonimi "guximtari" me 43 (dyzetë e tre) fletë. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
20. Deklasifikimin e plotë të dosjes së përpunimit, në ngarkim të Q.M me142 (njëqind e dyzetë e dy) fletë. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
21. Deklasifikimin e plotë të dosjes personale nr. 6726, në ngarkim të I.H, pseudonimi "shkëmbi", me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Mirditë.
22. Deklasifikimin e plotë të dosjes formulare nr. 771, në ngarkim të shtetasit M.K me 126 (njëqind e njëzetë e gjashtë) fletë. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Korçë.
23. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 501, në ngarkim të shtetasit I.K.
24. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 2497, në ngarkim të shtetasit J.B.
25. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 536, në ngarkim të shtetasit Z.N.
26. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr.10999, në ngarkim të shtetasit L.D.
27. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr.1188, në ngarkim të shtetasit O.S.
28. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 10880, në ngarkim të shtetasit L.GJ.
29. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr.1054, në ngarkim të shtetasit SH.H.
30. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 6207, në ngarkim të shtetasit DH.S.
31. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 2007, në ngarkim të shtetasit N.S.
32. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 2937, në ngarkim të shtetasit A.GJ.
33. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 6423, në ngarkim të shtetasit E.L.
34. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 679, në ngarkim të O.L.
35. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 640, në ngarkim të H.XH.
36. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 680, në ngarkim të D.L.
37. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 34, në ngarkim të I.B.
38. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 48, në ngarkim të I.J.
39. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 587, në ngarkim të R.SH.
40. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 565, në ngarkim të B.GJ.
41. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, në ngarkim të SH.Ç.
42. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 3330 në ngarkim të GJ.K.

43. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 5398 në ngarkim të Y.SH.
44. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 6391 në ngarkim të E.L.
45. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 5280 në ngarkim të S.R.
46. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 8493 në ngarkim të S.Q.
47. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 7228 në ngarkim të N.K.
48. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, nr. 6508 në ngarkim të Q.XH.
49. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, në ngarkim të M.S.
50. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, në ngarkim të shtetasit P.G.
51. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, N. 480 në ngarkim të shtetasit T.M.
52. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, në ngarkim të shtetasit M.K.
53. Deklasifikimin e plotë të Kartelës Model 2, në ngarkim të shtetasit I.P.

II. Marrjen në shqyrtim dhe deklasifikimin pjesërisht të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", që gjendet si më poshtë:

1. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 679, në ngarkim të O.L.
2. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 244, në ngarkim të F.D.
3. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 34, në ngarkim të I.B.
4. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 48, në ngarkim të I.J.
5. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 87, në ngarkim të K.H.
6. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 587, në ngarkim të R. SH.
7. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 743, në ngarkim të E.SH.
8. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 3856, në ngarkim të SH.Ç.
9. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 1116, në ngarkim të A.L.
10. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 640, në ngarkim të H.XH.
11. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 3353, në ngarkim të R.L.
12. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 642, në ngarkim të SH.L.
13. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 680, në ngarkim të D.L.
14. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 678, në ngarkim të I.P.
15. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 308, në ngarkim të D.S.

16. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 346, në ngarkim të B.GJ.
17. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 765, në ngarkim të P.S.
18. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 777, në ngarkim të K.XH.
19. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 3442, në ngarkim të E.T.
20. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 1395, në ngarkim të N.T.
21. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 5280, në ngarkim të S.R.
22. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 6165, në ngarkim të DH.TH.
23. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 6711, në ngarkim të Y.R.
24. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr.1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 2405, në ngarkim të G.P.
25. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 8854, në ngarkim të J.DH.
26. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 6391, në ngarkim të E.L.
27. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 5694, në ngarkim të I.I.
28. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 5398, në ngarkim të V.SH.
29. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 1, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 3796, në ngarkim të M.S.
30. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 7927, në ngarkim të N.D.
31. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 9043, në ngarkim të K.M.
32. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 8303, në ngarkim të A.D.
33. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 7265, në ngarkim të Q.R.
34. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 6291, në ngarkim të M.S.
35. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 6508, në ngarkim të Q.XH.
36. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Gramsh Grupi II-të, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 1302, në ngarkim të Q.XH.
37. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 5034, në ngarkim të V.G.
38. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 5266, në ngarkim të XH.N.

39. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 6426, në ngarkim të G.H.
40. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 7288, në ngarkim të N.K.
41. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Nr. 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 8840, në ngarkim të A.GJ.
42. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Model 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 9852, në ngarkim të E.K.
43. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Model 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 8493, në ngarkim të S.Q.
44. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Elbasan Model 2, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 8547, në ngarkim të GJ.K.
45. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mat nr. 18, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 3330, në ngarkim të Gj.K.
46. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Sarandë, Nr. 1, Model 2, grupi II, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 2516 në ngarkim të P.G.
47. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Sarandë, Nr. 1, Model 2, grupi II, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 819 në ngarkim të L.GJ.
48. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Sarandë, Nr. 1, Model 2, grupi II, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 2497 në ngarkim të J.B.
49. Deklasifikimin e pjesshëm të fotokopje e Listës së veçimit nr. 1, datë 25.07.1991 në ngarkim të bashkëpunëtorit “bregu” me 3(tre) fletë.
50. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë nr. 54, Grupi 2/B, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 65 në ngarkim të P.N.
51. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë nr. 54, Grupi 2/B, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 119 në ngarkim të M.B.
52. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë nr. 54, Grupi 2/B, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 307 në ngarkim të M.B.
53. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë nr. 54, Grupi 2/B, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 325 në ngarkim të N.N.
54. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë Model 10, nr. 45, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 400 në ngarkim të T.M.
55. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë Model 10, nr. 45, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 476 në ngarkim të M.K.
56. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë nr. 54, Grupi 2/B, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 201 në ngarkim të I.K.
57. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë Model 10, nr. 45, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. 444 në ngarkim të Z.N.
58. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë Model 10, nr. 45, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. 243 në ngarkim të Z.A.
59. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë Model 10, nr. 45, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. 469 në ngarkim të Q. M.
60. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë Model 10, nr. 45, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 473 në ngarkim të L.D.
61. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë Model 10, nr. 45, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 1188 në ngarkim të O.S.

62. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë Model 10, nr. 45, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 276 në ngarkim të L.GJ.
63. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë Model 10, nr. 45, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 487 në ngarkim të SH.H.
64. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë Model 10, nr. 45, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 480 në ngarkim të DH.S.
65. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë Nr. 1, Grupi 2/B konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet rendor 460 në ngarkim të N.S.
66. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë Model 10, nr. 45, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 474 në ngarkim të A.Gj.
67. Deklasifikimin e pjesshëm të Fletë regjistri i agjenturës Mirditë Model 10, nr. 45, konkretisht rreshti i fletës ku evidentohet nr. rendor 451 në ngarkim të H.B.

KRYETARI I KDZH
Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 5. datë 17.02.2020

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror"", i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"", kreu II, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me Urdhër nr.13, datë 03. 05. 2018, të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror"" në AIDSSH", ka bërë deklasifkimin e plotë dhe të pjesshëm të dokumenteve të klasifikuara "sekret shtetëror", me vendimin nr. 5. datë 17.02.2020 si më poshtë vijon:

Fondi arkivor i ish - Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

1. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1980, Shtabi, Dosja nr.17, me titull *"Përgjithësime, konkluzione dhe letra dërguar degëve të punëve të brendëshme mbi personat e arratisur në Jugosllavi e Greqi, mbi masat për parandalimin e arratisjeve jashtë vendit",* me 53 fletë.
2. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1977, Dega, Dosja nr.117, me titull *"Përgjithësime mbi nxitjen e arratisjes nëpërmjet kanalit postar",* me 9 fletë.
3. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1962, Bandat, Dosja nr.167, me titull *"Statistika mbi personat e arratisur për tentativ arratisje dhe të larguar në drejtim të paditur",* me 9 fletë.
4. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1963, Dega II, Dosja nr.98/1, me titull *"Relacion dërguar Këshillit të Ministrave mbi analizën e veprimtarisë armiqësore në drejtim të arratisjeve dhe agjitacionit dhe propagandës",* me 22 fletë.
5. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1972, Dega I, Dosja nr.440/19, me titull *"Informacion dërguar shokut Hysni Kapo mbi tendencat e arratisjes për personat në mosh të re",* me 3 fletë.

6. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1966, Dega I, Dosja nr.410, me titull *"Relacion mbi arratisjen e 4 personave në rrethin e Gjirokastrës",* me 3 fletë.

7. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1990, Shtabi, Dosja nr.19, me titull *"Studim për të arratisurit dhe refugjatët",* me 24 fletë.
8. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1983, Dega I-rë, Dosja nr.76, *"Informacione në lidhje me veprimtarinë e emigracionit politik shqiptar",* me 85 fletë.
9. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1975, Dega I-rë, Dosja nr.51, me titull *"Udhëzim dërguar degëve të brendshme mbi veprimtarinë armiqësore të emigracionit reksionar jashtë shtetit",* me 5 fletë.
10. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1962, Dega I-rë, Dosja nr.329, me titull *"Shënime, korrespodencë, informata të ndryshme që bëjnë fjalë mbi veprimtarinë e emigracionit shqiptarë dhe të kundër zbulimit të huaj kundër vendit tonë",* me 20 fletë.
11. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1985, Dega I-rë, Dosja nr.111, me titull *"Informacione mbi realizimin e arratisjeve",* me 29 fletë.
12. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1984, Dega I-rë, Dosja nr.96, me titull *"Analiza e tendencës së arratisjes, bërë nga degët në rrethe",* me 164 fletë.
13. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1984, Dega I, Dosja nr.72, *"Disa konkluzione që dalin për forcimin e masave për prevenimin e arratisjeve e ruajtjen e kufirit",* me 14 fletë.
14. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1984, Dega I, Dosja nr.73, *"Informacione mbi veprimtarinë armiqësore nëpërmjet arratisjes si dhe arratisjet e ndodhura gjatë vitit 1984",* me 8 fletë. Niveli I klasifikimit "Sekret".
15. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1984, Dega I, Dosja nr.74, *"Plan pune dhe informacioni i Drejtorisë së I për zbulimin, parandalimin dhe goditjen në kohë të tendencës së arratisjes në DPB të rretheve Tiranë, Shkodër, Krujë",* me 13 fletë.
16. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1984, Dega I, Dosja nr.75, *"Informacion i Drejtorisë I mbi arratisjet e bëra gjatë vitit 1983-1984 së bashku me listën dërguar KQ të PPSH",* me 8 fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
17. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1984, Dega I, Dosja nr.76, *"Përgjithësim i Drejtorisë I për zbulimin e goditjen e nje grupi armiqësor me tendencë arratisje jashtë shtetit në fshatin Hocisht të rrethit të Korçës", me 6 fletë.*
18. Fondi nr.4, Drejtoria e I-rë, Viti 1983, Dega III, Dosja nr.130, *"Konkluzione të Degës III për shkaqet e arrtisjeve të ndodhura gjatë 6 mujorit të parë të vitit 1983",* me 13 fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret".
19. Rregjistër për personat e kapur në kufi për tentativë arratisje, nr. 1041 me 300 (treqind) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
20. Dosje Kërkimi për disa të arratisur me aktivitet nr. 956, me në ngarkim të Kosta Mërtiri, Kosta Gjika, Andrea Kolaveshi, Ilia Mërtiri, Gazmend Nelaj etj, me 60 (gjashtëdhjetë) fletë.
21. Fashikull për të arratisurit dhe lidhjet në ngarkim të Faik Shefqet Ymeri, Tomorr Hasan Gora etj me 51 (pesëdhjetë e një) fletë.
22. Dosje drejtimi nr. 293 në ngarkim për ish kulakët, ish klerin reaksionar, ish borgjezinë dhe grupe të tjera të deklasuara, 6 vëllime me 109 (njëqind e nëntë) fletë në total.
23. Dosje nr. 99, me 4 albume fotografish me 236 (dyqind e tridhjetë e gjashtë) fletë në total.

24. Dosar me fotografi për të arratisurit, konkretisht 2 albume me 42 (dyzetë e dy) fletë në total dhe 16 zarf me 574 (pesëqind e shtatëdhjetë e katër) fotografi si dhe 6 (gjashtë) fletë me lista emërore për të arratisurit.

25. Dosje me pasqyra statistikore për të arratisurit, me 75 (shtatëdhjetë e pesë) fletë.
26. Rregjistër i të arratisurve jashtë shtetit, grupi i II/B, me 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) fletë.
27. Dosar me lista për të arratisurit, 15 fashikuj për 15 rrethe me 611 (gjashtëqind e njëmbëdhjetë) fletë në total.

KRYETARI I KDZH
Gentiana Sula

VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR PERIUDHËN JANAR-SHKURT

VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR PERIUDHËN JANAR-SHKURT

1. Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit mes AIDSSH dhe qendrës MEMO

10 janar 2020 – Në mjediset e AIDSSH-së, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Qendrës Memo, mes znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe znj. Ema Andrea, Drejtore ekzekutive e Memo. Objekt i marrëveshjes është institucionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e kujtesës gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së Sigurimit së Shtetit, për rivlerësimin e personaliteteve dhe ngjarjeve historike, si dhe kontributi në realizimin e projekteve të memories. U konkretizua bashkëpunimi mes AIDSSH-së dhe Memo. Të dy institucionet do të bashkërendojnë punën për projekte në funksion të dialogut për demokracinë, bazuar në materialet arkivore mbi rolin dhe funksionimin e ish-Sigurimit të Shtetit në shtet e shoqëri.

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, Memo synon të inkurajojë studimet e thelluara të ngjarjeve historike dhe individëve të lidhura me projekte muzeale, kujtese, të rishqyrtimit të historisë apo edukimit qytetar, si dhe të nxisë zbatimin e rezultateve të kërkimeve shkencore të reja historike në programin e edukimit shkollor.

Autoriteti dhe Memo do të bashkëpunojnë për hartimin e planeve të përbashkëta vjetore të aktiviteteve e nismave për edukimin qytetar, seminare, tryeza pune, etj. Bashkëpunimi synon të konsolidojë punën për njohjen e së shkuarës, në funksion të transparencës dhe komunikimit kompleks të fakteve publikut brenda dhe jashtë vendit.

2. Vizitë e ambasadorit izraelit Noah Gal Gendler, në AIDSSH

Ambasadori i Izraelit në Shqipëri, z. Noah Gal Gendler, zhvilloi një vizitë në mjediset e AIDSSH-së, ku u njoh me punën dhe projektet e institucionit, po ashtu rolin e tij për drejtësinë tranzicionale në vend.
Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula, bëri një paraqitje të punës së AIDSSH për zbardhjen e së shkuarës, nismat për hapjen dhe studimin e dosjeve nëpërmjet aktiviteteve në nivel lokal e kombëtar dhe bashkëpunimet me institucionet homologe e grupet e interesit. Ambasadori i Izraelit, z. Noah Gal Gendler, shprehu mbështetje për veprimtarinë e institucionit.

Më herët, AIDSSH zhvilloi një vizitë studimore në Yad Vashem, Muzeun Botëror të Holokaustit dhe Kujtesës, për të përfituar nga përvoja e tyre muzeale, po ashtu e ruajtjes, prezantimit dhe ekspozimit të dokumentacionit, digjitalizimit dhe edukimit. E gjitha e mbështetur në një platformë komunikimi ndërvepruese, të gjallë dhe në kontakt me të interesuarit anekënd globit.

3. Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit mes AIDSSH dhe Universitetit Europian të Tiranës

16 janar 2020 – Në mjediset e AIDSSH-së, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Universitetit Europian të Tiranës, mes znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe znj. Nevila Nika, Rektore e UET.
Objekt i marrëveshjes është institucionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e kujtesës gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së Sigurimit së Shtetit, nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese dhe trajnimeve, për të rritur ndërgjegjësimin në brezat e rinj, nëpërmjet edukimit qytetar dhe mbështetjes së kërkimit shkencor.
"Në këtë vit të rëndësishëm reflektimi të 30 viteve demokraci të Shqipërisë, marrëveshja me UET synon të bashkërendojë punën e Autoritetit dhe të studiuesve e studentëve të këtij universiteti, duke kontribuar në kalendarin e ndryshimeve demokratike dhe 100 vjetorin e Tiranës. Të dy institucionet do të organizojnë punën për projekte në funksion të dialogut për demokracinë, bazuar në materialet arkivore mbi rolin dhe funksionimin e ish-Sigurimit të Shtetit në ngjarje të rëndësishme të historisë sonë," u shpreh Kryetarja e Autoritetit, znj. Sula.

"Si një ndër mbështetëset dhe bashkëpunëtoret e para të Autoritetit, e vetëdijshme për sfidat me të cilat përballet institucioni, konkretizimin e bashkëpunimit me Universitetin Europian të Tiranës e

shoh si një hap drejt zgjerimit të kërkimit shkencor nga degët e masterit dhe doktoraturës, në çështje me interes kombëtar e po ashtu, drejt nxitjes së projekteve të edukimit qytetar", theksoi znj. Nevila Nika, Rektore e UET.
AIDSSH dhe UET do të punojnë për hartimin e planeve të përbashkëta vjetore për aktivitete të kalendarit të kujtesës, nisma për edukimin qytetar, seminare, tryeza pune, etj. Bashkëpunimi synon të konsolidojë punën për njohjen e së shkuarës, në funksion të transparencës dhe komunikimit me qytetarët.



4. Përvoja polake në zbardhjen e së shkuarës dhe rikthimin e dinjitetit viktimave të totalitarizmit. Vizitë e AIDSSH në IPN, Instituti Kombëtar i Kujtesës

Tiranë, 3-6 shkurt 2020 - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zhvilloi një vizitë pune në Varshavë më 3-6 shkurt, me ftesë të Institutit Kombëtar të Kujtesës në Poloni.
Takimet e ekipit të AIDSSH dhe përfaqësuesve të Kuvendit të Shqipërisë u organizuan sipas programit të bashkërenduar me institucionin homolog polak, Institute of National Remembrance-Instytut Pamieci Narodowej.
Më 4 shkurt, delegacioni shqiptar u prit nga drejtues të kërkimeve historike në IPN, z. Jerzy Bednarek, z. Rafal Leskiewicz dhe znj. Agnieszka Jedrzak, drejtuese e departamentit të marrëdhënieve ndërkombëtare pranë Presidentit të IPN.
Veprimtaria e AIDSSH-së, shtyllat mbi të cilat institucioni organizon punën e vet dhe mundësitë për bashkëpunim, u trajtuan nga kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula, dhe anëtarët, z. Simon Mirakaj, z. Marenglen Kasmi dhe z. Altin Hoxha. Ligji 45/2015 mbi të cilin mbështet punën AIDSSH dhe ndryshimet e propozuara për përmirësimin e tij në zbardhjen e së shkuarës, shërbimit

të dokumentacionit qytetarëve, verifikimit të figurave dhe edukimit qytetar u diskutuan nga z. Skënder Vrioni, sekretar i përgjithshëm dhe znj. Mirela Lame, shefe e sektorit juridik, me praninë e deputetëve të Komisionit të Ligjeve, znj. Artemis Dralo dhe z. Edmond Leka.
Përvoja e konsoliduar e Institutit Kombëtar Polak të Kujtesës, njëherësh Komisioni për Ndjekjen e Krimeve Kundër Popullit Polak i vjen në ndihmë AIDSSH-së në përballje me të shkuarën komuniste dhe trajtimin e saj në të sotmen, në respekt të të dënuarve të ndërgjegjes, viktimave, të mbijetuarve dhe nxitjes së dialogut shoqëror për demokraci.
Më 5 shkurt, pranë zyrave qendrore të IPN u zhvillua takimi me zv/Presidentin e Institutit Kombëtar të Kujtesës, njëherësh zv/ Drejtor i Kërkimit Shkencor dhe i Plotfuqishëm për krimet e kryera ndaj kombit polak, z. Krzysztof Szwagrzyk. Z. Szwagrzyk foli për përvojën e tij në fushën e të zhdukurve, që nga viti 1998 kur nisi ky proces me të zhdukurin e parë, duke vazhduar me identifikimin e gjetjen e varrezave masive edhe në mes të qyteteve kryesore, për të vazhduar me kërkimet sistematike. Sot llogariten rreth 50.000 të zhdukur, 50% e të cilëve, të vrarë dhe të zhdukur nga Stalini.
Më tej, z. Mateusz Szpytma, zv/President i Institutit Kombëtar të Kujtesës, bëri një paraqitje të veprimtarisë së institucionit, i krijuar në vitin 2000. Ligji për krijimin e IPN u miratua në Parlamentin Polak në vitin 1998 dhe si ligj funksional ka pësuar ndryshime ligjore katër herë në themel dhe dhjetëra herë pjesërisht për të ardhur në modelin e sotëm.
Zv/ Presidenti e informoi delegacionin shqiptar për punën kërkimore shkencore që bëhet nga IPN, bazuar në punën shkencore të historianëve, botimet, studimet, etj., që pasurojnë burimet për kurrikulën shkollore.
Pas takimeve, delegacioni vizitoi arkivin e IPN dhe ndoqi organizimin e arkivave fizike dhe elektronikë, po ashtu proceset e punës së digjitalizimit, botimeve, etj, i shoqëruar nga drejtoresha e arkivit, znj. Marzena Kruk.
Sot, IPN është institucion i konsoliduar me përvojë 20-vjeçare, me 2500 punonjës dhe 16 zyra lokale në mbarë vendin, i organizuar sipas tre drejtimeve kryesore: arkivi, prokuroria dhe kërkimi shkencor.
Arkivi me parametra bashkëkohorë administron informacion të pasur, që kontribuon në rezultatet e punës së departamenteve të tjerë, prokurorisë, kërkimit shkencor, botimeve e më gjerë.
Prokuroria përbëhet nga 135 prokurorë, shërbim burgjesh dhe komisioni mbi krimet e nazistëve për vitet 1945-1985; 135 prokurorët hetojnë punën e institucionit te tyre të ish-policisë sekrete, pjesë e Ministrisë së Sigurisë Publike 1945-1954. Pas përfundimit të punës hetimore, prokurorët bëjnë deklarim në Gjykatë, e cila jep vendimin përfundimtar. Brenda Prokurorisë ekziston një sektor për lustracionin/vetingun, i cili trajton rreth 300.000 kërkesa në vit.
Drejtuesi i Prokurorisë brenda Institutit Kombëtar të Kujtesës është njëherësh zv/Ministër i Drejtësisë. Prokuroria ka çuar në proces gjyqësor rreth 10.000 çështje për genocid, krime kundër njerëzimit dhe krime kundër kombit polak. Në vitin 1991, personave të dënuar gjatë regjimit komunist iu dha pafajësia me ligj të veçantë.
Kërkimi shkencor është departament ku organizohen drejtimet e punës kërkimore, edukimit, memorialeve, kërkimit të eshtrave (sektor i posaçëm për kërkimin e të zhdukurve, me arkeologë, teknikë e mjekë ligjorë).
Pjesë e Institutit është edhe sektori që propozon dhënien e medaljes “Kryqi i Lirisë dhe Solidaritetit” për qytetarët që u përballën me dinjitet njerëzor me totalitarizmin dhe mekanizmat e shtypjes.
Përvoja polake në trajtimin e së shkuarës, përballjes me të dhe modeli i një institucioni kujtese që mbështet dinjitetin njerëzor dhe nxit dialogun shoqëror, - duke i trajtuar në thellësi plagët e së

shkuarës, për të siguruar të tashmen e të ardhmen, - është e rëndësishme për një institucion si AIDSSH dhe kontributin e tij në mbajtjen gjallë të kujtesës kolektive.
Më 6, 7 shkurt, AIDSSH u përfaqësua nga Kryetarja Sula në Rrjetin Europian të Kujtesës dhe Solidaritetit në takimet e përvitshme të Rrjetit, në të cilat mori pjesë edhe Ministrja e Kulturës e Shqipërisë, znj. Elva Margariti.

5. Tiranë, 19 shkurt 2020, Konferencë ndërkombëtare shkencore me temë "Emigracioni politik shqiptar në vitet 1944-1990".

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Institutin për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë, Muzeun Historik Kombëtar, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Europës dhe Institutin "Ali Hadri" Prishtinë zhvilloi konferencën ndërkombëtare shkencore me temë "Emigracioni politik shqiptar në vitet 1944-1990".

Konferenca dhe ekspozita dokumentare mbi emigracionin u prezantuan përgjatë gjithë ditës në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar.

Për konferencën mbi emigracionin politik, AIDSSH dhe MEPJ ekspozuan dokumente të shumta arkivore, si pasqyra statistikore për të arratisurit, dosje drejtimi dhe kërkimi për të arratisur e të deklasuar, regjistra për personat në tentativë arratisjeje dhe albume fotografike të të arratisurve, që u përkasin qyteteve të ndryshme të vendit. Materialet arkivore janë pjesë e një fondi të pasur mbi emigracionin politik, që u është vënë në dispozicion studiuesve, mes të cilave, ngjarjet e ambasadave, organizatat politike, historia e familjes Popa dhe dosje mbi të arratisurit. U paraqitën fakte mbi qëndrimin e shtetit shqiptar ndaj veprimtarisë së të ashtuquajturit "emigracion reaksionar" jashtë vendit, Komiteti "Shqipëria e Lirë", harta gjeografike e shpërndarjes së tij, propaganda dhe antipropaganda e përgatitur për t'u përdorur në çdo situatë, emigracioni i vjetër politik dhe shtimi i radhëve të tij me të arratisur të tjerë nga Shqipëria. Znj. Gentiana Sula, kryetare e Autoritetit, bëri një paraqitje të punës së AIDSSH që çoi në realizimin e konferencës së parë mbi emigracionin politik, në bashkëpunim me partnerët: "....Në këtë problematikë komplekse, natyrisht do të prekim temat e nxehta, por jam e sigurt që diskutimi do të vazhdojë. Rreth 13.600 persona u numëruan të arratisur në raportet e Sigurimit të Shtetit, nga 1944 deri në vitin 1990, pa llogaritur ato të ikur përmes ambasadave. Nga këta, rreth 4784 ishin gra dhe fëmijë. Dominonin këtu të ikurit e vitit 1945 dhe 1948. Në shifrat e larta të emigracionit të shqiptarëve në shekuj dhe gjatë tranzicionit të zgjatur, kjo përmasë duket vetëm një fraksion. Por ky fraksion është shumë i rëndësishëm për vendin tonë. Të integruar tërësisht në shoqëritë pritëse, sot ata paraqesin një urë të fortë komunikimi me vendet më të zhvilluara dhe me aleatët tanë. Ato nuk reshtën së dashuri Shqipërinë dhe së qeni aktivë në forma të ndryshme, duke denoncuar shkeljet e të drejtave njerëzore në Shqipërinë komuniste dhe duke ngritur zërin për të drejtat kombëtare".

Në 30-vjetorin e ndryshimeve demokratike në vend, konferenca mbi emigracionin politik hedh dritë në një Shqipëri të survejuar, shumë të përfolur e të keqinterpretuar për vite me radhë.

Z. Bernd Borchardt, ambasador i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, u shpreh se: "Duke parë Shqipërinë e sotme, unë vërej argumente të forta që e mbështesin këtë pikëpamje akademike: Shpesh dëgjojmë – dhe sa më i ndezur debati, aq më shpesh ndodh – fajësim pa kursim për ata që mendojnë ndryshe. Nuk dëgjojmë vetëm argumente kundër këndvështrimeve të tyre, gjë që do të ishte normale, por dëgjojmë përpjekje për t'u zhbërë figurën. Dëgjojmë refuzimin e dialogut me kundërshtarin politik. Dëgjojmë sulme ndaj atyre që përpiqen të vendosin faktet përballë miteve.

E gjitha kjo më duket si mbetje nga modeli i sjelljes komuniste. Sikurse e përshkruajnë shkencëtarët, në pak vende polarizimi politik është kaq i thellë sa në Shqipëri dhe "përballja me të kaluarën", me krimet e neveritshme të diktaturës komuniste, vetëm sa ka filluar...

Komisionet e së vërtetës kanë luajtur rol thelbësor në shumë vende pas mizorive të diktaturave. Kultura e kujtesës e lidhur me viktimat dhe me vuajtjet përforcon ndryshimin e rrëfimit që është i nevojshëm për të ndërtuar një shoqëri liberale pas shpërbërjes së një diktature. Siç e ka përkufizuar presidenti i ndjerë i Çekisë Václav Havel: ndryshimi nga "të jetosh brenda gënjeshtrës apo brenda të vërtetës".

Thënë kjo, konferenca e sotme përbën një tjetër hap të rëndësishëm e të nevojshëm drejt të kësaj të vërtete. Vrasjet e njerëzve që përpiqeshin të largoheshin nga Shqipëria, ekzekutimi i atyre që kapeshin ndërsa përpiqeshin të largoheshin, eksodi i një pjese të mirë të elitës së para luftës në vitin 1944, largimi i detyruar i bashkëshortëve të huaj të shqiptarëve pas shkëputjes me Bashkimin Sovjetik – së bashku sollën kaq shumë dhimbje te njerëzit. Kjo vuajtje e meriton të theksohet këtu

– dhe të jetë pjesë e përballjes me të kaluarën e keqe".

Koordinatori i Përhershëm i OKB në Shqipëri, z. Brian Williams, tha se: "Nëse kam një mesazh për të transmetuar sot për këtë konferencë, është që Kombet e Bashkuara besojnë fuqimisht që zbulimi i plotë dhe i vërtetë e së shkuarës ka vlerë direkte sa i takon përpjekjeve të sotme për të ndërtuar demokracinë. Ka lindur nevoja për një proces gjithëpërfshirës të zbulimit të së vërtetës në Shqipëri- dhe këtu dua të nënvizoj e mbështes çdo gjë që kolegu im i OSBE tha mbi këtë temë. Historia e Shqipërisë ka rëndësi absolute për situatën e sotme. Si mund t'u kërkosh qytetarëve t'u besojnë institucioneve qeverisëse, nëse këto institucione nuk hedhin dritë dhe nuk bëjnë të njohur gabimet e tyre në të shkuarën? Të marrësh përgjegjësi për gabimet e së shkuarës nuk është një shenjë dobësie, është akt kuraje. Të japësh llogari për të shkuarën -drejtësinë tranzicionale- është kusht i nevojshëm për të ndërtuar institucione llogaridhënëse dhe demokratike në Shqipëri". Ministri i Diasporës, z. Pandeli Majko përshëndeti konferencën duke e lidhur emigracionin e sotëm me atë të para '90-s, duke paraqitur dallimet thelbësore të tyre dhe rrëfyer përvojën personale me të arratisur në familje përgjatë diktaturës.

Z. Ermal Frashëri, anëtar i Komitetit të Punëtorëve Migratorë në OKB bëri paraqitjen "Migracioni global dhe regjimet politike" mbi emigracionin e sotëm, problematikat që shfaq ai dhe bashkësinë shqiptare të shpërndarë në botë.

I larguar me ambasadat në 1990, z. Gjon Radovani, arkitekt, ndau përvojën personale të largimit nga diktatura për në botën e lirë dhe u shpreh mbi dinamikat e emigracionit në epokën globalizuese.
Z. Dritan Sejko, kryetar i shoqatës "Çamëria", trajtoi përvojën e komunitetit çam me emigracionin.
Në vijim, konferenca trajtoi punimet shkencore të periudhës 1944-1955, në moderimin e Prof. Asoc. Dr. Pranvera Dibra.

Studiuesit Beqir Meta, Dorian Koçi, Hamit Kaba, Enriketa Pandeleimoni, Romeo Gurakuqi dhe Leonora Laçi trajtuan tema, si: Vatra dhe regjimi komunist: nga partneriteti në armiqësi; Emigracioni politik shqiptar 1945-1953 përmes dosjeve të UDB-së; Emigracioni politik në SHBA pas Luftës së Dytë Botërore: Raportet me 'emigracionin e vjetër'; Qëndrimi i Italisë ndaj operacionit 'Rollback'; "Kriminelët e luftës": Emigracioni politik shqiptar në Itali dhe raporti me shtetin komunist shqiptar 1945 – 1955; Komiteti Kombëtar "Shqipëria e lirë" dhe veprimtaria e emigracionit në vitet 1949 – 1953; Blloku kombëtar indipendent, i drejtuar nga Ernest Koliqi;

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Adresa
Garda e Republikës, Rr. “Ibrahim Rugova”, Tiranë
www.autoritetidosjeve.gov.al